

VENDIM
Nr. 140, datë 23.7.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 30, DATË 14.2.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURËN E CAKTIMIT TË GJYQTARIT PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE TË VEÇANTË, NË NJË GJYKATË TJETËR, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN NË MËNYRË TË PËRHERSHME”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 3, të nenit 4, në pikën 1, të nenit 147, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 2, 89, 97 dhe 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës

VENDOSI:

Në vendimin nr. 30, datë 14.2.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, bëhen këto shtesa:

Pas paragrafit X, të shtohet paragrafi X/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“X/1 Dispozitë për Gjykatën e Lartë

1. Ky vendim do të zbatohet edhe për Gjykatën e Lartë derisa pranë saj të jetë funksionale një trupë gjykuese.

2. “Nevoja të Gjykatës së Lartë” në kuptim të këtij vendimi konsiderohen vetëm ato që lidhen me gjykimin e çështjeve gjyqësore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, ekskluzivisht me ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar, për të cilat shkronja “c”, pika 3, e nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale parashikon që vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është vendimi i Gjykatës së Lartë.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor vihet në lëvizje me kërkesë të Kancelarit të Gjykatës së Lartë.

4. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Lartë për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit, të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

